



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në pajtim me nenin 47, paragrafi (1), pika 6 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21 dhe 74/24), dhe në bazë të nenit 42, paragrafi (9), pikat 1),2),3),4) dhe 5) dhe nenit 100, paragrafi (5) të Ligjit të Shërbimeve Pagesore dhe të Sistemeve Pagesore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 90/22 dhe 64/24) dhe nenit 4, paragrafi (4) dhe nenit 24, paragrafi (3) të Ligjit të Veprimtarisë me Valutë të Huaj, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 34/01, 49/01, 103/01, 51/03, 81/08, 24/11, 135/11, 188/13, 97/15, 153/15 dhe 23/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

V E N D I M

për realizimin e transaksioneve pagesore

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim përshkruhen:

- kushtet dhe procedura e hapjes dhe mbylljes së llogarive pagesore në denarë dhe valutë të huaj, duke përfshirë edhe llogaritë pagesore me funksione thelbësore në denarë, nga ana e ofruesve të shërbimeve pagesore nga neni 9, paragrafi (1), pikat 1), 2), 3), 5) dhe 7) të Ligjit të Shërbimeve Pagesore dhe të Sistemeve Pagesore (në tekstin e mëtejme: Ligji);
- kushtet dhe procedurat për realizimin e transaksioneve pagesore;
- elementet e detyrueshme dhe format e udhëpagesave, përfshirë edhe urdhëpagesat për arkëtim të detyrueshëm, si dhe forma për shprehjen e pëlqimit për realizimin e transaksioneve pagesore dhe autorizim për bartjen e llogarisë pagesore.
- kushtet dhe procedura për korrigjim të gabimit të transaksioneve pagesore dhe
- kushtet për vënien në dispozicion të mjeteve financiare të pranuesit.

2. Disa shprehje të përdorura në këtë vendim kanë kuptimin si në vijim:

- 2.1. "Personalizimi i kartelës pagesore" është regjistrimi i të dhënave të duhura për përdoruesin e autorizuar të shërbimeve pagesore në kartelën pagesore;
- 2.2. "Numri personal i identifikimit (PIN)" është mjet sigurie i personalizuar dhe ka të paktën katër shifra;
- 2.3. "BBAN" (ang. BBAN = Basic Bank Account Number) është identifikues për numrin e llogarisë pagesore, i cili pa mëdyshje identifikon llogari pagesore individuale me ofruesin e shërbimit pagesor në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe e cila mund të përdoret vetëm për transaksionet pagesore nacionale përderisa llogaria pagesore e njëjtë është e identifikuar me IBAN për transaksionet pagesore ndërkufitare;
- 2.4. "IBAN" (ang. IBAN = International Bank Account Number) është identifikues i numrit të llogarisë pagesore ndërkombëtare, e cila pa mëdyshje identifikon llogari pagesore individuale, elementet e të cilës janë të specifikuara nga Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit (ISO) (ang. the International Organization for Standardization);

- 2.5. "BIK" (ang. BIC= Business identifier code) është shenjë identifikuese biznesi e cila pa mëdyshje e identifikon ofruesin e shërbimeve pagesore, elementet e të cilit janë të specifikuara nga ISO-ja;
 - 2.6. "ISO 20022 XML standard" është standard për krijim të porosive financiare elektronike siç është përcaktuar nga ISO-ja, i cili përfshin paraqitje fizike të transaksioneve pagesore në sintaksën e XML-it, në pajtim me rregullat e afariste dhe udhëzuesit e zbatimit në vend ose skemat e pagesave në SEPA për transaksionet e pagesave që rregullohen me këtë vendim;
 - 2.7. "Pagesë" është pjesë e transaksionit të ngarkimit direkt që fillon me inicimin e tij nga ana e pranuesit deri në përfundimin e tij në formën e ngarkimit normal në llogarinë pagesore së paguesit;
 - 2.8. Termi "mikro-tregtar" ka kuptimin e përcaktuar në Ligjin e Shoqërive Tregtare;
 - 2.9. "Pala referente kontraktuese" është person fizik ose juridik në emër të të cilit paguesi ekzekuton ose përfituesi merr pagesën.
 - 2.10. "Sistemi pagesor për pagesa të mëdha" është sistem pagesor, qëllimi kryesor i të cilit është përpunimi, klirimi ose shlyerja e transaksioneve individuale të pagesave me prioritet dhe urgjencë të lartë dhe që kanë të bëjnë kryesisht me shuma të mëdha;
 - 2.11. "Sistemi pagesor për pagesa të vogla" është sistem pagesor, qëllimi kryesor i të cilit është përpunimi, pastrimi dhe/ose shlyerja e transfertave të kredisë ose debitimeve direkte, të cilat përgjithësisht janë të grupuara për transferim dhe kanë të bëjnë kryesisht me shuma të vogla dhe me prioritet të ulët, dhe që nuk është një sistem pagesash i madh;
 - 2.12. "Transaksion pagesor ndërkufitar" është transaksion pagesor i iniciuar nga paguesi ose përfituesi ku ofruesi i shërbimit pagesor të paguesit ose ofruesi i shërbimeve pagesore të marrësit është themeluar dhe vepron në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe ofruesi tjetër i shërbimeve pagesore është themeluar dhe operon në një vend tjetër anëtar të SEPA-s, përveç Republikës së Maqedonisë së Veriut;
 - 2.13. "Transaksioni i pagesave nacionale" është transaksioni pagesor i inicuar nga paguesi ose përfituesi ku ofruesi i shërbimit të pagesave të paguesit dhe ofruesi i shërbimit të pagesave të marrësit ose ofruesi i shërbimit pagesor të paguesit i cili është ofrues i shërbimeve pagesore dhe marrësi janë themeluar dhe operojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
 - 2.14. "SEPA" nënkupton Zonën e Vetme të Pagesave në Euro;
3. Dispozitat e këtij vendimi zbatohen edhe për transaksionet e pagesave me transfertë krediti dhe debitime direkte të cilat ekzekutohen në euro në skemat e pagesave SEPA, me përjashtim të rasteve kur janë këto transaksione pagesore:
- të përpunojë dhe të shlyejë nëpërmjet sistemeve pagesore për pagesat e mëdha, me përjashtim të transaksioneve të pagesave me debitime direkte, realizimi i të cilave nëpërmjet sistemit pagesor për pagesat e mëdha nuk kërkohet shprehimisht nga paguesi;
 - të realizuara me kartelë pagesore ose pajisje tjetër, duke përfshirë transaksionet e pagesave për tërheqje parash, me përjashtim të rasteve kur përdoret kartelë pagesore ose pajisje tjetër për të marrë informacionin e nevojshëm për të nisur një transferim kredie ose debitim direkt në ose nga një llogari pagesore e identifikuar nga BBAN-i ose IBAN-i;
 - të realizuara me pajisje telekomunikacioni, digjitale ose informacioni nëse transaksione të tilla pagesore nuk rezultojnë në fillimin e një transferimi

kredie ose debitimi direkt në ose nga llogari pagesore e identifikuar me BBAN-i ose IBAN;

- Transaksionet pagesore të transfertave të parave;
Transaksionet pagesore me para elektronike, përveç rasteve kur transaksionet rezultojnë në transfertë krediti ose debitim direkt në ose nga llogari pagesore e identifikuar me BBAN ose IBAN.

Nëse skemat e pagesave bazohen në kryerjen e transaksioneve të pagesave me transfertat krediti ose debitime direkte, por kanë veçori ose shërbime shtesë, dispozitat e kreut VIII të këtij vendimi zbatohen vetëm për transfertat bazë të kredisë ose debitimet direkte.

II. KUSHTET DHE PROCEDURAT E HAPJES DHE TË MBYLLJES SË LLOGARIVE PAGESORE

4. Llogaria pagesore hapet dhe mirëmbahet nga ofruesi i shërbimeve pagesore në emër të një ose më shumë përdoruesve të shërbimeve pagesore dhe e njëjta përdoret për realizimin e transaksioneve pagesore.

Llogaria pagesore hapet pas nënshkrimit të marrëveshjes kornizë për përdorimin e shërbimeve pagesore, ndërmjet ofruesit të shërbimeve pagesore dhe shfrytëzuesit të shërbimeve pagesore, në pajtim pajtueshmëri me dispozitat e pjesës së tretë, të kreut III të ligjit, Ligjit të Veprimtarisë me Valuta si dhe dispozitat të këtij vendimi.

Nëse ofruesi i shërbimeve pagesore refuzon të lidhë marrëveshje kornizë, ai është i detyruar të deklarojë arsyet e refuzimit, me përjashtim të rasteve kur zbulimi i arsyeve të refuzimit do të ishte në kundërshtim me objektivat e sigurisë kombëtare, rendit dhe qetësisë publike ose rregulloret që rregullojnë zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Informacionet para nënshkrimit të marrëveshjes kornizë

5. Para nënshkrimit të marrëveshjes kornizë nga pika 4) e këtij vendimi, ofruesi i shërbimeve pagesore është i detyruar t'i sigurojë përdoruesit e shërbimeve pagesore informacionin e mëparshëm, në pajtim me dispozitat e nenit 56 të ligjit.

6. Informacionet e mëparshme nga pika 5) e këtij vendimi jepet nga ofruesit e shërbimeve pagesore në formën e informacionit të përgjithshëm dhe kushteve të mëparshme për përdorimin e shërbimeve pagesore ose në formën e një projekt marrëveshje kornizë.

Dhënia e informacioneve të mëparshme nga paragrafi (1) i kësaj pike nuk përbën detyrim për të lidhur marrëveshje kornizë, ndërmjet ofruesit të shërbimeve pagesore dhe personit të cilit i jepet informacioni.

7. Ofruesi i shërbimeve pagesore është i detyruar në ofertën e shërbimeve pagesore për konsumatorët të përfshijë hapjen e llogarisë pagesore me funksione bazë dhe të ndërmarrë aktivitete të duhura për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për disponueshmërinë e llogarive pagesore me funksione themelore.

8. Veprimtaritë nga pika 7) e këtij vendimi përfshijnë veçanërisht dhënien e një fletëpalosjeje informative për llogarinë pagesore me funksionet themelore dhe tarifat e zbatueshme të shërbimeve pagesore, e cila është e disponueshme në çdo kohë.

9. Fletëpalosja informative duhet të jetë e disponueshme në formë letre në ambientet e punës të ofruesve të shërbimeve pagesore, në të cilat kanë qasje përdoruesit e shërbimeve pagesore dhe në formë elektronike, nëpërmjet faqeve të internetit të ofruesve të shërbimeve pagesore.

10. Ofruesit e shërbimeve pagesore mund të përfshijnë informacione shtesë nga ato që përmbahen në fletëpalosjen e pikës 8) të këtij vendimi, nëse kjo nuk ndikon në paraqitjen e qartë dhe të saktë të informacionit.

Hapja e llogarisë pagesore

11. Ofruesi i shërbimeve pagesore mund të hapë llogari pagesore me kërkesë të një rezidenti ose jorezidenti (në tekstin e mëtejshëm: kërkuesi), si dhe me kërkesën e personit që vepron në emër dhe në llogari të tij.

Pas marrjes së kërkesës për hapjen e llogarisë pagesore nga paragrafi (1) i kësaj pike, ofruesi i shërbimeve pagesore duhet ta identifikojë dhe ta konfirmojë identitetin e kërkuesit, si dhe personit që vepron në emër të tij dhe në llogari të tij, në pajtim me Ligjin e Parandalimit të Larjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 151/22).

12. Kërkuesi që synon të hapë llogari pagesore, së bashku me kërkesën e hapjes së llogarisë pagesor, ofruesi i shërbimeve pagesore dorëzon edhe kopje të nënshkrimeve të personave që veprojnë në emër të tij dhe në llogari të tij (ang. Specimen), përveç rastit kur ofruesi i shërbimeve pagesore dhe konsumatori nuk dakordohen për mënyrë tjetër të vërtetimit të personave që veprojnë në emër të tij dhe në llogari të tij.

Nënshkrimet e këtyre personave duhet të depozitohen tek ofruesi i shërbimeve pagesore në prani të zyrtari të autorizuar nga ofruesi i shërbimeve pagesore, ose të jenë të vërtetuara nga noteri.

Krahas dokumenteve dhe informacioneve nga paragrafi (1) i kësaj pike, nëse kërkuesi është konsumator që paraqet kërkesë për hapjen e llogarisë pagesore me funksione themelore, tek ofruesi i shërbimeve pagesore dorëzon:

- deklarata me shkrim në pajtim me nenin 72, paragrafi (3) të ligjit,
- dokument përkatës për të dëshmuar të drejtat ligjore në pajtim me nenin 74, paragrafi (4) të ligjit nëse konsumatori bën pjesë në grupin e shfrytëzuesve të të drejtave ligjore të përcaktuara me ligjin.

Me përjashtim të paragrafit (1) të kësaj pike, nëse llogaria pagesore hapet nëpërmjet mjeteve të komunikimit në distancë dhe është e disponueshme vetëm për iniciimin e transaksioneve pagesore elektronike nëpërmjet mjeteve të komunikimit në distancë, kërkuesi nuk paraqet kopjen nga paragrafi (1) i kësaj pike.

13. Ofruesit e shërbimeve pagesore në pajtim me aktet interne mund të kërkojnë dokumente të tjera për hapjen dhe mbajtjen e llogarisë pagesore, për të cilën e njoftojnë paraprakisht kërkuesin që synon të hapë llogari.

14. Ndryshimet në dokumentet nga pikat 11), 12) dhe 13) të këtij vendimi ofruesi i shërbimeve pagesore që mirëmban llogarinë pagesore i zbaton nga momenti kur i njëjti njoftohet me shkrim ose nëpërmjet komunikimit elektronik nga përdoruesi i shërbimeve pagesor edhe/ose personi që vepron në emër të tij dhe në llogari të tij.

15. Ofruesi i shërbimeve pagesore nuk guxon që personit fizik i cili ka status rezident dhe ka hapur llogari pagesore në denarë dhe/ose në valutë të huaj, njëkohësisht t'i hapë dhe/ose t'i mirëmbajë llogaritë pagesore në denarë dhe/ose në valutë të huaj me status jorezident, ose anasjelltas. Nëse në pajtim me Ligjin e Veprimtarisë me Valutë të Huaj, krijohen kushte për ndryshimin e statusit nga rezident në jorezident, ose anasjelltas, ofruesi i shërbimeve pagesore është i obliguar ta ndryshojë statusin (jo) rezident në person fizik.

16. Ofruesi i shërbimeve pagesore është i detyruar me kërkesë të konsumatorit të transferojë llogarinë e tij pagesore te një ofrues tjetër i shërbimeve pagesore në pajtueshmëri me procedurën për zbatim të shërbimit të bartjes në pajtim pajtim me dispozitat nga pjesa e katërt, kapitulli IV i ligjit .

Autorizimi për transferimin e llogarisë pagesore mund të jepet në formë të shkruar nëpërmjet komunikimit me shkrim ose elektronik në pajtim pajtim me marveshjen kornizë për përdorim të shërbimeve pagesore të lidhura ndërmjet ofruesit të shërbimeve pagesore dhe shfrytëzuesit të shërbimeve pagesore.

Mbyllja e llogarisë pagesore

17. Mbyllja e llogarisë pagesore bëhet në pajtim pajtueshmëri me dispozitat e nenit 60 të ligjit, me kërkesë me shkrim të shfrytëzuesit të shërbimeve pagesore ose nga ofruesi i shërbimeve pagesore pas përfundimit të marrëveshjes kornizë sipas së cilës është hapur.

18. Pas mbylljes së llogarisë së pagesave, ofruesi i shërbimit pagesor i kthen përdoruesit e shërbimeve pagesore ose pasardhësit ligjor, respektivisht personit të përcaktuar me ligj ose rregullore tjetër, ia kthen fondet që kanë mbetur në llogarinë e pagesës kur është mbyllur në pajtim me udhëzime për kthimin e fondeve të përcaktuara nga ana e tij.

Nëse ofruesi i shërbimit pagesor nuk ka marrë udhëzime për kthimin e mjeteve nga përdoruesi i shërbimeve pagesore ose pasardhësi ligjor, respektivisht personi i përcaktuar me ligj ose një rregullore tjetër, fondet transferohen në një llogari regjistrimi me një qëllim të veçantë dhe vepron me ta në pajtim me nenin 60, paragrafët (8) dhe (9) të ligjit.

19. Ofruesi i shërbimit pagesor që ka iniciuar më parë bllokimin e një llogarie pagesore të një shfrytëzuesi të shërbimit pagesor ndaj të cilit është hapur procedura e falimentimit ose likuidimit ose është fshirë një person juridik ose një person juridik që ka pushuar së ekzistuari në bazë të ligjit, vendimi i gjykatës ose me urdhër të organit kompetent, së bashku me procedurën për mbylljen e llogarisë pagesore, i njofton të gjithë ofruesit e shërbimeve pagesore se llogaritë pagesore janë zhblokuar për përpunim të mëtejshëm të tyre.

Nëse në llogaritë pagesore të shfrytëzuesit të shërbimeve pagesore ndaj të cilëve janë hapur procedurat e falimentimit ose likuidimit, ekzistojnë bllokime të cilat janë iniciuar nga një ofrues i shërbimit pagesor ndaj të cilit, pas realizimit të bllokimit, ka filluar procedura e falimentimit ose likuidimi njoftimi nga paragrafi (1) të kësaj pike kryhet nga ofruesi i

shërbimit pagesor tek i cili drejtuesi i falimentimit ose likuiduesi hap një llogari pagesore të përdoruesit të shërbimeve pagesore në falimentim ose likuidim.

Nëse në llogaritë pagesore të përdoruesit të shërbimeve pagesore ndaj të cilëve janë hapur procedurat e falimentimit ose likuidimit, ka blloqe të iniciuara nga ofruesi i shërbimit pagesor ndaj të cilit, pas zbatimit të bllokadës, kanë filluar procedurat e falimentimit ose likuidimi, njoftimi nga paragrafi (1) i kësaj pike bëhet nga ofruesi i shërbimit pagesor, i cili drejtues i falimentimit ose likuiduesi hap llogarinë e pagesës të përdoruesit të shërbimeve pagesore në falimentim ose likuidim.

Nëse në llogaritë pagesore të shfrytëzuesit të shërbimeve pagesore është person juridik i fshirë ose person juridik që ka pushuar së ekzistuari në bazë të ligjit, vendimi të gjykatës ose me urdhër të organi kompetent, ka bllokime të iniciuara nga një ofrues i shërbimit pagesor ndaj të cilit, pas bllokimit, janë nisur procedurat e falimentimit ose likuidimi, njoftimi nga paragrafi (1) i kësaj pike bëhet nga ofruesi i shërbimit pagesor i cili është hapur llogaria pagesore të ofruesit të shërbimeve pagesore në falimentim ose likuidim.

III. KUSHTET DHE PROCEDURAT PËR REALIZIMIN E TRANSAKSIONEVE PAGESORE DHE ELEMENTEVE TË DETYRUARA TË URDHËRPAGESAVE

20. Transaksionet pagesore nëpërmjet llogarive pagesore mund të realizohet vetëm me urdhër të mbajtësit të llogarisë pagesore me pëlqimin paraprak të tij të dhënë me qëllim të zbatimit së transaksioneve pagesore, përfshirë transaksionet pagesore me debitim direkt dhe/ose urdhëresë të përhershëm, deri në shumën dhe kushtet e përcaktuara nga mbajtësi.

Me përjashtim, dispozitat e paragrafit (1) të kësaj pike nuk zbatohen në rast të arkëtimit të detyrueshëm sipas të procedurës së përshkruar me dispozitat e pjesës së shtatë, kreut III të ligjit.

Për transaksionet pagesore jashtë vendit, përveç dispozitave të këtij vendimi zbatohen edhe dispozitat e Ligjit të Veprimtarisë me Valutë të Huaj dhe aktin nënligjor të Bankës Popullore, i cili përcakton mënyrën dhe kushtet për kryerjen e transaksioneve pagesore jashtë vendit.

Urdhërpagesa

21. Urdhërpagesa mund të jepet me shkrim në formë letre ose në formë elektronike, në pajtim me marrëveshjen kornizë për përdorimin e shërbimeve pagesore ose ofertës së përgjithshme, respektivisht kontratës për realizimin e një transaksioni të njehershëm të pagesës të lidhur ndërmjet ofruesit të shërbimeve pagesore dhe përdoruesit të shërbimeve pagesore.

Urdhërpagesat zbatohen në mënyrë të plotë dhe sipas rendit kronologjik të mbërritjes së tyre tek ofruesi i shërbimit pagesor në pajtim me kushtet e pjesës së katërt, kapitulli III të ligjit.

Zbatimi i urdhërpagesave

22. Me rastin e zbatimit të urdhërpagesës, ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar të përdorin mjete teknike që sigurojnë pajtueshmërinë me dispozitat e ligjit.

Me rastin e dorëzimit të urdhëresës të bartjes në sistemin e pagesave për zbatimin e urdhërpagesës, ofruesi i shërbimit pagesordorëzon të gjitha të dhënat nga urdhërpagesa në pajtim me rregullat e sistemit pagesor.

Valuta e transaksionit pagesor është valutë në të cilën paguesi ka iniciuar urdhërpagesën ose ka dhënë pëlqimin për zbatimin e transaksionit të pagesës.

Të gjitha transaksionet pagesore, si dhe njoftimet nga përdoruesi i shërbimeve pagesore në pajtim me nenin 85, paragrafi (1), pika 3) të ligjit, regjistrohen në rend kronologjik nga ofruesi i shërbimit pagesor në mënyrë që siguron ruajtjen e sigurt dhe riprodhimin e saktë të informacionit dhe parandalon çdo ndryshim të mëtejshëm dhe ruhen për periudhën e parashikuar në nenin 127 të këtij ligji.

Nëse llogaria pagesore së pranuesit e specifikuar në urdhërpagesë është e mbyllur ose nuk ekziston, ofruesi i shërbimit pagesor ia kthen pranuesit shumën e transaksionit pagesor të paekzekutuar deri në fund të ditës së ardhshme të punës pas ditës së pranimit të mjeteve. Për të kthyer shumën, ofruesi i shërbimit pagesor pranuesit mund t'i paguajë kompensim në shumën e kostove vijuese të bëra.

Ofruesi i shërbimit pagesor mund të refuzojë të kryejë transaksion pagesor në pajtim me rregulloret, rregullat që janë respektivisht të zbatueshme për zbatimin e transaksioneve të pagesore dhe kushtet e marrëveshjes kornizë sipas së cilës mbahet llogaria e pagesës.

Gjatë zbatimit të urdhërpagesës, ofruesi i shërbimit pagesor është i detyruar të fusë në sistemet e tij të informacionit një kod përkatës sipas standardit ISO "20022 XML" për përshkrimin e pagesës të futur nga paguesi gjatë zbatimit të urdhërpagesave për transfert e kreditsë ose remitanca, domethënë nga pranuesi gjatë zbatimit të urdhërpagesave për debitime direkte. Ofruesi i shërbimit pagesor është i detyruar t'i japë kodin për përshkrimin e pagesës ofruesit të shërbimit pagesor të pranuesit gjatë zbatimit të urdhëresave pagesore për transfertat e kredive ose remitancat, përkatësisht ofruesit të shërbimit pagesor të paguesit gjatë zbatimit të urdhërpagesave për debitimet direkte.

Për transaksionet pagesore jashtë vendit, përveç kodit për përshkrimin e pagesës sipas standardit ISO "20022 XML" nga paragrafi (7) i kësaj pike, ofruesi i shërbimit pagesor është i detyruar të fusë në sistemet e tij të informacionit një kod përkatës bazuar në listën e kodet e rregulluara me akt nënligjor të Bankës Popullore për mënyrën dhe kushtet e kryerjes së transaksioneve të pagesore jashtë vendit.

Disponueshmëria e mjeteve për zbatimin e urdhërpagesave

23. Urdhërpagesa mund të zbatohet vetëm deri në shumën e disponueshme në llogarinë pagesore, deri në shumën e mjeteve të ofruara nga përdoruesi i shërbimeve pagesore për kryerjen e transaksionit pagesor, ose deri në shumën e kredisë, nëse i njehti është dakorduar. Transferet e pjesshme të urdhërpagesave individuale nuk lejohen, me përjashtim të rastit të një urdhërpagese me arkëtim të detyruar.

Nëse nuk plotësohen kushtet nga paragrafi (1) i kësaj pike, ofruesi i shërbimeve pagesore refuzon të zbatoj urdhërpagesën dhe vepron në pajtim me nenin 95 të ligjit.

Transferet kreditore

24. Transferi kreditor është shërbim pagesor ku paguesi jep udhëzime ofruesit të shërbimit pagesor që mban llogarinë e tij të pagesës për të kryer transaksion pagesor ose një seri transaksionesh pagesore me të cilën miratohet llogaria pagesore e pranuesit.

Paguesi plotëson urdhërpagesën për kryerjen e transferit kreditor duke përcaktuar elementet e detyrueshme nga pika 25) e këtij vendimi dhe përgjigjet për pasojat e rezultuara nga plotësimi i gabuar.

25. Urdhërpagesa për zbatimin e transfereve kreditore duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

- Përcaktimin e ofruesit të shërbimit pagesor të cilit i është caktuar urdhërpagesa;
- emërtimin e paguesit;
- numrin e llogarisë pagesore (IBAN ose BBAN) ose identifikues tjetër unik të paguesit;
- numrin tatimor të paguesit nëse transfertat e kredisë kryhet në favor të një përdoruesi buxhetor;
- emërtimin e marrësit;
- numrin e llogarisë pagesore (IBAN ose BBAN) ose identifikues tjetër unik të marrësit;
- shumën e transferimit kreditor;
- valutën e transferimit kreditor;
- datën e zbatimit (valuta) ;
- përshkrimin e pagesës ;
- sqarime shtesë për pagesën ;
- emrin e sistemit pagesor;
- datën e parashtrimit;
- nënshkrimin e paguesit.

Urdhërpagesa për zbatimin e transferit kreditor jashtë vendit, përveç elementeve nga paragrafi (1) i kësaj pike, patjetër duhet të përmbajë edhe këto elemente:

- BIK-ë shenjë identifikuese të ofruesit të shërbimit pagesor të pranuesit;
- caktimin e përdoruesit të shërbimeve pagesore që paguan kompensimet për zbatimin e transferimit kreditor;
- përcaktimi i vendbanimit të paguesit;
- përcaktimi i vendbanimit të pranuesit.

Urdhërpagesa për transferimin kreditor, përveç informacioneve dhe/ose të dhënave nga paragrafi (1) dhe (2) i kësaj pike, mund të përmbajë edhe informacione tjera dhe/ose të dhëna, duke përfshirë dhe informacionet dhe/ose të dhënat që janë të nevojshme për pajtueshmëri me aktet nënligjore të Bankës Popullore për mënyrën dhe kushtet për kryerjen e transaksioneve të pagesore jashtë vendit dhe me rregulloret tjera.

Me iniciimin elektronik të urdhërpagesës së transferimit kreditor, ofruesi i shërbimeve pagesore së paguesit pas autentifikimit të paguesit mund të plotësojë automatikisht informacione dhe/ose të dhëna të caktuara nga paragrafi (1) dhe (2) i kësaj pike në urdhërpagesë bazuar në disponueshmërinë e tyre në sistemin e tij informativ.

Urdhërpagesa për arkëtim të detyrueshëm

26. Urdhërpagesa për arkëtim të detyrueshëm mund të hartohet nga përmbaruesi ose organ tjetër kompetent në pajtim me ligjin dhe t'i dorëzohet ofruesit të shërbimeve pagesore, me të cilin ai kërkon kryerjen e transaksionit pagesor në bazë të një dokumenti për arkëtim të detyruar.

Përmbaruesi ose organ tjetër kompetent, në pajtim me ligjin, plotëson urdhërpagesën për arkëtim të detyrueshëm duke përcaktuar elementet e detyrueshme nga pika 27) e këtij vendimi dhe përgjigjet për pasojat e rezultata nga mbushja e gabuar.

27. Urdhërpagesa për arkëtim të detyrueshëm duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:

- emërtimin e ofruesit të shërbimit pagesor të cilit i është caktuar urdhërpagesa;
- emërtimin e përdoruesit të shërbimeve pagesore – debitori;
- emërimin e ofruesit të shërbimeve pagesore të përmbaruesit ose autoritetit tjetër kompetent në pajtim me ligjin;
- numrin e llogarisë pagesore (IBAN ose BBAN) ose shenjë tjetër unike identifikuese e përdoruesit të shërbimeve pagesore - debitorit;
- emërimin e përmbaruesit ose autoritetit tjetër kompetent në pajtim me ligjin,
- numrin e llogarisë pagesore (IBAN ose BBAN) ose shenjë tjetër unike identifikuese e përmbaruesit ose organit tjetër kompetent në pajtim me ligjin;
- shumën e transaksionit pagesor(borxhi kryesor, interesi dhe kompensime dhe kostot e tjera që lidhen me zbatimin);
- datën e zbatimit;
- numrin e dokumentit të arkëtimit të detyrueshëm;
- datën e dorëzimit të urdhërpagesës;
- nënshkrimin elektronik të përmbaruesit ose organit tjetër kompetent në pajtim me ligjin.

Debitime direkte

28. Debitimi direkt është shërbim pagesor me të cilën debitohet llogaria pagesore e paguesit, me ç'rast transaksionin pagesor e fillon pranuesi në bazë të pëlqimit të shprehur nga paguesi.

Para fillimit të kryerjes së debitimeve direkte, paguesi shpreh pëlqimin dhe i jep miratimin ofruesit të shërbimit pagesor që mban llogarinë e tij pagesore dhe të marrësit, në bazë të të cilit pranuesi mund të fillojë mbledhjen e mjeteve me debitim direkt në llogarinë pagesore të paguesit.

Paguesi plotëson pëlqimin për debitim direkt në pajtim me kërkesat e pikës 29) të këtij vendimi dhe përgjigjet për pasojat e plotësimit të gabuar të pëlqimit për debitim direkt.

Pëlqimi për debitim direkt mund të jepet me shkrim në formë letrë ose në formë elektronike sipas marrëveshjes së lidhur kornizë për përdorim të shërbimeve të lidhura me pagesë ndërmjet ofruesit të shërbimeve pagesore dhe përdoruesit të shërbimeve pagesore.

Pranuesi duhet të i transmetojë të dhënat lidhur me pëlqimin tek ofruesi i shërbimit pagesor në çdo debitim direkt të përsëritur ose pagese të njëhershme. Të dhënat e lidhura

me pajtueshmërinë e debitimit direkt duhet të transferohen nga ofruesi i shërbimit pagesor i pranuesit, tek ofruesi i shërbimit pagesor të paguesit si pjesë e pagesës.

Për iniciimin e debitimit direkt, pranuesi plotëson urdhërpagesë për debitim direkt, në pajtim me kërkesat në pikën 30) të këtij vendimi dhe përgjigjet për pasojat e plotësimit të gabuar.

Pranuesi mund të dërgojë urdhërpagesën e debitimit direkt tek ofruesi i shërbimit pagesor të pranuesit pasi t'i dërgojë një njoftim paraprak paguesit.

Ofruesi i shërbimit pagesor të pranuesit është i detyruar të marrë urdhërpagesën për debitim direkt dhe të ja dorëzojë ofruesit të shërbimit pagesor të paguesit, pa detyrimin për të kontrolluar bazën e përdorimit të debitimit direkt.

Përpara realizimit të urdhërpagesës së debitimit direkt, ofruesi i shërbimit pagesor të paguesit është i detyruar të verifikojë nëse:

- ka pëlqim paraprak për debitim direkt, sipas pikës 29) të këtij vendimi,
- llogaria pagesore së paguesit ka fonde të mjaftueshme në dispozicion ose është miratuar kredi për realizimin e urdhërpagesës për debitim direkt, dhe
- janë përmbushur kushtet për realizimin e urdhërpagesës për debitim direkt, duke përfshirë dorëzimin e dokumenteve të nevojshme për realizimin e tij, nëse paraprakisht është rënë dakord për dorëzimin e tyre.

Urdhërpagesa për debitim direkt realizohet nga ofruesi i shërbimit pagesor të paguesit brenda afatit sipas nenit 99 të Ligjit, duke llogaritur nga data në të cilën janë plotësuar kushtet e paragrafëve (8) dhe (9) të kësaj pike.

Nëse brenda 5 ditëve pune nga marrja e urdhërpagesës për debitim direkt nuk plotësohen kushtet nga paragrafët (8) dhe (9) të kësaj pike, ofruesi i shërbimit pagesor të paguesit refuzon të realizojë urdhërpagesën për debitim direkt dhe njofton ofruesin e shërbimit pagesor të pranuesit.

Nëse ofruesi i shërbimit pagesor dhe pranuesi janë i njëjti person, ofruesi i shërbimit pagesor mund të debitojë llogarinë pagesore të paguesit të hapur me të, për shumat që zotëruesi i llogarisë i detyrohet, në bazë të pëlqimit. Ofruesi i shërbimit pagesor informon mbajtësin për bazën, datën e monedhës dhe shumën e mjeteve të debituara nga llogaria e tij pagesore.

Përmbajtja e pëlqimit të debitimit direkt

29. Pëlqimi i debitimit direkt, përmban:

- shenjën unike të referimit të pëlqimit,
- emrin dhe adresën të ofruesit të shërbimit pagesor të paguesit, të cilit i është dhënë pëlqimi,
- emërtimin e paguesit,
- numrin e llogarisë pagesore (IBAN ose BBAN) ose identifikues tjetër unik të paguesit,
- emërtimin e pranuesit,
- shenjën unike të referimit të pranuesit,
- datën e fillimit dhe përfundimit të vlefshmërisë së pëlqimit,
- kushtet në të cilat është dhënë pëlqimi, dhe
- nënshkrimin e paguesit, vendin dhe datën e dorëzimit të pëlqimit.

Në bazë të marrëveshjes ndërmjet paguesit dhe ofruesit të tij të shërbimit pagesor, pëlqimi i debitimit direkt mund të përmbajë gjithashtu informacione dhe/ose të dhëna të tjera nga ato të përcaktuara në paragrafin (1) të kësaj pike.

Përmbajtja e urdhërpagesës së debitimit direkt

30. Urdhërpagesa për debitim direkt duhet të përmbajë:

- emërtimin e ofruesit të shërbimit pagesor të cilit i është caktuar urdhërpagesa,
- llojin e debitimit direkt (i përsëritur, një herë, i pari, i fundit ose revokim),
- emërtimin e pranuesit,
- numrin e llogarisë pagesore (IBAN ose BBAN) ose identifikues tjetër unik i pranuesit që do të miratohet për arkëtim,
- shenjën e vetme identifikuese të pranuesit,
- emërtimin e paguesit,
- numrin e llogarisë pagesore (IBAN ose BBAN) ose identifikues tjetër unik i paguesit i cili do të debitohet për arkëtimin,
- shenjën unike të referimit të pëlqimit,
- datën e dorëzimit të pëlqimit,
- shumën e pagesës,
- valutën e pagesës,
- datën e dorëzimit të urdhërpagesës,
- datën (valuta) e zbatim,
- përshkrimin e pagesës,
- sqarime shtesë dhe
- nënshkrimin e pranuesit.

Urdhërpagesa për debitim direkt përveç informacioneve të përcaktuara në paragrafin (1) të kësaj pike mundet të përmbajë edhe informacione të tjera dhe/ose të dhëna, duke përfshirë dhe informacionin dhe/ose të dhënat e nevojshme për pajtueshmërinë me rregulloret tjera.

Gjatë inicimit elektronik të urdhërpagesës për debitim direkt, ofruesi i shërbimeve pagesore së pranuesit, pas vërtetimit të pranuesit, mund të plotësojë automatikisht në urdhërpagesë informacione dhe/ose të dhëna të caktuara nga paragrafi (1) i kësaj pike bazuar në disponueshmërinë e të njejtave në sistemin e tij të informacionit.

Remitanca

31. Remitanca është shërbimi pagesor me të cilëm pranohen fonde parash nga pagues, me qëllim që, shuma e duhur e parave të transferohet te pranuesi ose në një tjetër ofrues të shërbimeve pagesore që vepron në emër dhe për llogari të pranuesit dhe/ose ku paratë merren në emër dhe për llogari të pranuesit dhe i vënë në disponimin e tij, po pa hapur llogarie pagesore në emër të paguesit ose pranuesit.

Përmbajtja e urdhërpagesës për remitanca

32. Urdhërpagesa për remitanca përmban:

- emërtimin e paguesit,

- adresën e paguesit, duke përfshirë shtetin e paguesit,
- shenjën e identifikimit unike të paguesit ose llogarinë e tij pagesore;
- emërtimin e pranuesit,
- shenjën unike të identifikimit të pranuesit ose llogarisë së tij pagesore;
- shumën e transaksionit pagesor,
- valutën e transaksionit pagesor,
- përshkrimin e pagesës,
- sqarime shtesë,
- datën e dorëzimit të urdhërpagesës, dhe
- nënshkrimin e paguesit.

Urdhërpagesa për transfertë parash, përveç të dhënave nga paragrafi (1) i kësaj pike, mund të përmbajë edhe të dhëna të tjera, duke përfshirë të dhënat që janë të nevojshme për pajtushëmi me rregulloret tjera.

Kartela pagesore

33. Kartelë e pagesës është instrument pagesor i personalizuar (kartelë debiti ose krediti) e cila përdoret në mënyrë të përsëritur për të identifikuar përdoruesin e autorizuar të shërbimeve pagesore, për qasje në distancë në llogarinë pagesore dhe/ose në kufi të përcaktuar më parë të rënë dakord ndërmjet ofruesit të shërbimeve pagesore dhe përdoruesit dhe me cilën munden të inicohen transaksione pagesore dhe transaksione të tjera si ndryshimi i PIN-it, kontrolli i gjendjes së llogarisë pagesore etj.

Kartela pagesore është pronë e ofruesit të shërbimit pagesor, lëshuesit të kartelës.

Kartela pagesore përdoret personalisht dhe vetëm nga një përdorues i autorizuar i shërbimeve pagesore.

Kartela pagesore lëshohet për një periudhë të caktuar të vlefshmërisë. Emri i përdoruesit të autorizuar të shërbimit pagesor, numri i kartelës pagesore dhe data e afatit shtypen në faqen e kartelës dhe/ose ruhen në një medium të përhershëm. Ofruesi i shërbimit pagesor, lëshuesi i kartelës pagesore është përgjegjës për personalizimin e kartelës.

Ofruesi i shërbimeve pagesore, lëshuesi i kartelës pagesore, i lëshon kartelën përdoruesit të autorizuar të shërbimeve pagesore brenda një periudhe jo më të gjatë se 28 ditë nga marrëveshjet e lidhura kornizë për shërbimet pagesore.

Lëshimi i kartelës pagesore kryhet pas marrëveshjes e lidhura kornizë për përdorimin e shërbimeve pagesore ndërmjet ofruesit të shërbimeve pagesore dhe shfrytëzuesit të shërbimeve pagesore, në pajtim me dispozitat e nenit 56 të Ligjit.

Karakteristikat e sigurisë së përdoruesit

34. Lëshuesi i kartelës siguron një PIN për çdo përdorues të autorizuar të shërbimit pagesor të lidhur me kartelën e tij të pagesës. Lëshuesi i kartelës i cakton një PIN çdo përdoruesi të autorizuar të shërbimeve pagesore, duke siguruar konfidencialitetin e tij.

Lëshuesi i kartelës pagesore është i detyruar t'i ofrojë çdo përdoruesi të autorizuar të shërbimeve pagesore mundësinë për të ndryshuar PIN-in e tij nëpërmjet bankomatit në vend me kombinim të ri katërshifror, të njohur vetëm për përdoruesin.

Kryerja e transaksioneve të pagesore me kartela pagesore nëpërmjet mjeteve të komunikimit në distancë, ofruesi i shërbimeve pagesore, i cili është lëshuesi i kartelës pagesore, është i detyruar t'i ofrojë përdoruesit të autorizuar të shërbimeve pagesore veçori të tjera të sigurisë së përdoruesit, përveç kodit PIN, të cilat sigurojnë përmbushjen e kërkesave për vërtetim të sforcuar nga neni 124 i ligjit.

Pranimi i kartelave pagesore dhe autorizimi i transaksioneve të kryera me ato

35. Transaksionet pagesore të bazuara në kartela pagesore autorizohen ose refuzohen pas kontrollit të të dhënave, parametrave dhe veçorive që lidhen me kartelën pagesore, përdoruesin e autorizuar të shërbimeve pagesore dhe transaksionin pagesor, si vlefshmëria dhe statusi i kartelës, kodi PIN ose tjetër veçoritë e sigurisë të përdoruesit (nëse kërkohet), disponueshmëria e mjeteve, limitet etj.

Në kushtet e autorizimit onlajn, kontrolli sipas pikës (1) të kësaj pike kryhet pa vonesë nga sistemi i autorizimit të ofruesit të shërbimit pagesor që ka lëshuar kartelën ose nga sistemi që i shërben subjektit përpunues, me të cilin është lidhur pajisja nëpërmjet një lidhje telekomunikacioni, nga e cila kryhet transaksioni i pagesës.

Në kushtet kur autorizimi nuk kryhet online, kontrolli sipas pikës 1 të kësaj pike kryhet pa vonesë nga pajisja, pa kontrolluar sistemin e autorizimit të ofruesit të shërbimit pagesor që ka lëshuar kartelën ose sistemin që i shërben subjektit që kryen përpunimin.

Pranimi i pagesave dhe zbatimi i transaksioneve të pagesore me kartela pagesore mund të kryhet nga një ofrues i shërbimit pagesor i ndryshëm nga lëshuesi i kartelës pagesore.

Në rast se pajisja ndodhet në një pikë shitjeje të një shitësi (pikë shitjeje fizike ose virtuale), të drejtat dhe detyrimet ndërmjet ofruesit të shërbimit pagesor dhe shitësit rregullohen nëpërmjet marrëveshjes që siguron pajtueshmëri me ligjin.

Marrëveshja nga paragrafi (5) i kësaj pike përmban të paktën kërkesat në vijim:

- llojin e kartelave pagesore me të cilat mund të kryhen transaksionet pagesore me kartelë tek shitësi;
- procedurat dhe detyrimet e zbatueshme të shitësit gjatë zbatimit të transaksioneve të pagesore me kartelë;
- afati dhe mënyra e pagesës nga ofruesi i shërbimit pagesor kundrejtë shitësit.

Zbatimi i transaksioneve me kartela pagesore me parapagesë

36. Një kartelë pagesore me parapagesë është lloj i instrumenti pagesor i personalizuar në të cilin ruhen paratë elektronike ose që ofron qasje në distancë në llogarinë e parasë elektronike dhe me të cilin kryhen transaksionet pagesore .

Lëshimi i kartelave pagesore me parapagesë, duke përfshirë edhe rastet kur emri i përdoruesit të autorizuar nuk shënohet në faqen e kartelës, zbatohet pas marrëveshjes e

lidhur kornizë në pajtim me Ligjin, në pajtim me kufijtë e transaksionit të skemave përkatëse të kartelave në kuadër të së cilës është lëshuar kartela, Ligjin dhe Ligjin e Parandalimit dhe të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit.

Kartela pagesore me parapagesë kanë PIN-in dhe lëshuesi i kartelës pagesore me parapagesë është i detyruar të zbatojë përcaktimet e pikës 34), paragrafi (1) dhe (2) të këtij vendimi. Lëshuesi i kartelës është i detyruar të i mundësojë çdo përdoruesi të autorizuar të shërbimeve pagesore të ndryshojë PIN-in e tij katërshifror me kombinim të ri numerik që e njeh vetëm ai.

Me përjashtim të paragrafit (3) të kësaj pike, kartela pagesore që mund të përdoret për kryerjen e transaksioneve të pagesore vetëm në një pikë shitje virtuale mund të mos ketë PIN.

Për kartelat pagesore me parapagesë do të zbatohen dispozitat e pikës 33), paragrafi (2), (3), (4) dhe (5) të këtij vendimi.

Refuzimi për të realizuar transaksion pagesor me kartelë pagesore

37. Ofruesi i shërbimit pagesor që kryen pranimin e transaksioneve të pagesore bazuar në kartela është i detyruar të kushtëzojë shitësin i cili është pranues i pagesës, për të refuzuar pagesën e një pajisjeje që ndodhet në pikën e shitjes së shitësit nëse ka:

- kartelë pagesore të pavlefshme;
- mospajtim ndërmjet nënshkrimit të përdoruesit të kartelës pagesore dhe nënshkrimit të tij në dokumentin e pranimin të transaksionit pagesor ose në dokumentin personal të identifikimit të përdoruesit ose ka mungesë të nënshkrimit të përdoruesit të kartelës pagesore nëse kërkohet për vlefshmërinë e tij;
- refuzim nga përdoruesi i kartelës pagesore për të paraqitur një dokument që konfirmon identitetin e tij ose nëse shitësi që është pranues i pagesës konstaton se një person i paaautorizuar po përdor kartelën pagesore;
- pamundësi për të siguruar konfirmimin e ekzekutimit të transaksionit pagesor;
- dyshimi për një kartelë pagesore të falsifikuar ose mashtruese;
- informacionin e dhënë më parë nga shitësi, se nuk pranon kartelë të përshtatshme pagesore në pajtim me nenin 119, paragrafi (4) dhe (5) të Ligjit, dhe
- arsye të tjera që nuk bien ndesh me legjislacionin në fuqi.

Shitësi që është pranues i pagesës mund të mbajë kartelën pagesore në emër të lëshuesit në rastet e alinesë 1, 2, 3 dhe 5 të paragraf 1 të kësaj pike në pajtim me procedurat e përcaktuara nga kontrata në pajtim me pikën 35 paragraf 5 dhe 6 të këtij vendimi.

V. VENDOSJA E MJETEVE PAGESORE NË DISPOZICION TË PRANUESIT

38. Ofruesi i shërbimeve pagesore është i detyruar që fondet nga transaksionet pagesore të i vë në dispozicion të pranuesit në pajtim me dispozitat e neneve 99 dhe 100 të ligjit.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike, ofruesi i shërbimeve të mjeteve pagesore nga transaksionet pagesore jashtë vendit i vë në dispozicion të pranuesit në pajtim me aktin

nënligjor që rregullon mënyrën dhe kushtet për kryerjen e transaksioneve të pagesore jashtë vendit.

VI . DEPOZITA DHE TERHEQJA E E PARAVE TË GATSHME

VI.1. Urdhra për depozitim ose tërheqje e parave të gatshme

39. Urdhri për depozitim të parave të gatshme në një llogari pagesore menjëherë në sportelet në ambientet e punës të ofruesit të shërbimit pagesor duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

- emërtimin e ofruesit të shërbimit pagesor të cilit i është caktuar urdhëri,
- emërtimin e depozituesit të parave të gatshme,
- numrin unik të identifikimit ose numër tjetër identifikues të depozituesit,
- numrin e dokumentit të identifikimit të depozituesit të parave të gatshme,
- emërtimin e pranuesit,
- numrin e llogarisë pagesore (IBAN ose BBAN) ose identifikues tjetër unik të pranuesit,
- shumën e parave të gatshme që depozitohen,
- vlerën e parave të gatshme që depozitohen,
- përshkrim të hyrjes,
- sqarime shtesë,
- shtetin e jorezidentit,
- datën e dorzimit, edhe
- nënshkrimin e depozituesit.

40. Urdhëresa për tërheqjen e parave të gatshme nga një llogari pagesore direkt në sportelet e ambienteve të punës së ofruesit të shërbimit pagesor duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

- Emërtimin e ofruesit të shërbimit pagesor të cilit i është caktuar urdhëri,
- emërtimin e mbajtësit të llogarisë pagesore,
- numrin e llogarisë pagesore (IBAN ose BBAN) ose identifikues tjetër unik të mbajtësit të llogarisë pagesore,
- emërtimin e pranuesit të parave të gatshme,
- numrin unik të identitetit ose një numër tjetër identifikimi të pranuesit të parave të gatshme,
- numrin e dokumentit të identifikimit të pranuesit të parave të gatshme,
- shumën e parave të gatshme që do të tërhiqen,
- valutë të parave të gatshme që po tërhiqen,
- përshkrimin e tërheqjes,
- sqarime shtesë,
- shtetin e jorezidentit,
- datën e dorzimit,
- nënshkrimin e mbajtësit të llogarisë pagesore, dhe
- nënshkrimi i pranuesit të parave të gatshme.

VI.2. Depozitimi i parave të gatshme në valutë të huaj në llogarinë pagesore të një jorezidenti

41. Ofruesi i shërbimeve pagesore mundëson depozitim të parave të gatshme në valutë të huaj në llogaritë pagesore të një jorezidenti në bazë të një urdhërpagese të

dorëzuar nga jorezidenti. Me depozitim të parave të gatshme, sipas rregulloreve pozitive të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dorëzohet edhe formular konfirmimi me shkrim për regjistrimin e parave të gatshme në denarë dhe valutë të huaj dhe çeqe që personat jorezidentë i sjellin ose i nxjerrin nga Republika e Maqedonisë së Veriut, të lëshuar nga Drejtoria Doganore e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Vërtetimi nga paragrafi (1) i kësaj pike mund të përdoret disa herë brenda pesë ditëve pune. Ofruesi i shërbimit pagesor regjistron çdo hyrje të valutës të huaj në llogarinë pagesore të jorezidentit, si dhe vërtetimin origjinal dhe mban një fotokopje të saj në regjistrat e tij.

Për qëllime të depozitimit të parave të gatshme në valutë të huaj në një llogari pagesore të një jorezidenti, konfirmimi nga paragrafi 1 i këtij artikulli është i vlefshëm për pesë ditë pune nga data e lëshimit të tij.

Me përjashtim, ofruesi i shërbimit pagesor mundëson depozitim të parave të gatshme në valutë të huaj në llogaritë pagesore të një jorezidenti, pa paraqitur konfirmimin nga paragrafi (1) i kësaj pike, në rastet e mëposhtme:

- gjatë një muaji, më së shumti deri në shumën për të cilën, në pajtim me rregulloret, me rastin e hyrjes në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk lëshohet vërtetim me shkrim i domosdoshëm;
- nëse mjetet vijnë nga paratë e pashpenzuara në valutë të huaj, të tërhequra më parë nga llogaritë e tij pagesore, brenda një periudhe tremujore nga dita e tërheqjes, ose
- nëse mjetet vijnë nga shitja e produkteve pasagjerëve në një aeroplan. Këto mjete mund të futen në llogarinë e pagesës në valutë të huaj nga kompania ajrore jorezidente që transporton pasagjerë nga ose në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ose nga një tjetër jorezident në bazë të marrëveshjes së duhur për marrjen e parave të gatshme nga kjo linjë ajrore dhe duke e futur atë në një llogari pagesore.

42. Ofruesi i shërbimeve pagesore mundëson depozitim të parave të gatshme në denarë në llogarinë pagesore të jorezidentit nëse buron nga:

- shitja e dokumente transporti vetanake nga përfaqësuesit e personave të huaj të cilët në Republikën e Maqedonisë së Veriut kryejnë punë agjencie në komunikacionin ajror në bazë të marrëveshjeve të lidhura ndërshtetërore për komunikacion të rregullt ajror,
- para të gatshme në denarë të pashpenzuara të tërhequr më parë nga llogaritë e tij pagesore në afat prej 3 muajsh nga dita e tërheqjes;
- shitja e produkte pasagjerëve në bord. Këto mjete mund të depozitohen në llogarinë pagesore në denarë nga kompania ajrore jorezidente që transporton udhëtarë nga ose në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ose nga një tjetër jorezident në bazë të marrëveshjes përkatëse për marrjen e parave të gatshme nga kjo linjë ajrore dhe hyrjen në llogari e pagese;
- gjatë një muaji, më së shumti deri në shumën për të cilën, në pajtim me rregulloret, lejohet hyrja falas e denarit në para të gatshme me hyrjen në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

43. Kufizimet për hyrjen e parave të gatshme në denarë dhe në deviza në llogaritë pagesore nga pikat 41) dhe 42) të këtij vendimi nuk vlejnë për përfaqësitë diplomatike të shteteve të huaja, përfaqësitë e organizatave ndërkombëtare dhe përfaqësuesit e tyre

ligjorë, si dhe për përfaqësuesit e huaj të personave fizik të identifikuar me dokument lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

VII. KUSHTET DHE PROCEDURAT PËR KORRIGJIM TË GABIMIT NË TRANSAKSIONET PAGESORE TË KRYERA ME PËRDORIM TË TRANSFERIT TË KREDISË DHE DEBITIMIT DIREKTE

44. Në rast të një transaksioni pagesor të realizuar në mënyrë të parregullt, ofruesi i shërbimit pagesor është përgjegjës sipas dispozitave të pjesës së katërt, kapitullit III të ligjit.

Në rastin e një transaksioni pagesor të kryer gabimisht, ofruesi i shërbimit pagesor të paguesit mund t'i kërkojë ofruesit të shërbimit pagesor të pranuesit të korrigjojë një gabim (ex-officio korrigjim të gabimit) ose ofruesi i shërbimit pagesor të pranuesit mundet me iniciativën e tij në detyrë profesionale të korrigjojë një gabim:

- nëse ofruesi i shërbimit pagesor të pranuesit ka miratuar një llogari pagesore me një shenjë identifikimi të ndryshëm dhe/ose një shumë të ndryshme nga ato të përcaktuara nga paguesi në urdhërpagesë,
- nëse ofruesi i shërbimit pagesor të paguesit ka debituar një llogari pagesore me një shenjë identifikimi të ndryshëm nga llogaria pagesore e caktuar nga paguesi në urdhërpagesën,
- nëse ofruesi i shërbimit pagesor të paguesit ka debituar llogarinë pagesore të paguesit me një shumë të ndryshme nga shuma e specifikuar nga paguesi në urdhërpagesë, ose
- në rast të zbatimit të transaksionit të autorizuar të pagesës më shumë se një herë.

45. Për të korrigjuar një gabim sipas detyrës zyrtare, ofruesi i shërbimit pagesor i paguesit dorëzon një kërkesë me shkrim për korrigjimin e gabimit, së cilës ai i bashkëngjit kopjet e deklaratës nga llogaria pagesore së paguesit dhe urdhërpagesën përkatëse dhe në rastin e debitimit direkt, një kopje e pëlqimit për debitim direkt.

46. Ofruesi i shërbimit pagesor të paguesit ka të drejtë të kërkojë korrigjimin e një gabimi në pajtim të detyrës zyrtare nga ofruesi i shërbimit pagesor brenda 5 ditëve pune nga data në të cilën ai i ka kthyer bilancit të llogarisë pagesore të debituar të paguesit në gjendje në të cilin do të ishte llogaria nëse transaksioni pagesorsë parregullt nuk do të ishte kryer fare, por jo më vonë se një muaj pasi paguesi është njoftuar ose është përcaktuar në një mënyrë tjetër për transaksionin pagesor të kryer në mënyrë të parregullt.

47. Nëse ofruesi i shërbimit të inicimit të pagesës është përgjegjës në rastet e pikës 44) të këtij vendimi, ai mund të paraqesë një kërkesë për korrigjim të gabimit në pajtim të detyrës zyrtare të ofruesi i shërbimit pagesor të pranuesit drejtpërdrejt ose nëpërmjet ofruesit të shërbimit pagesor që mban llogarinë pagesore të paguesit, brenda afatit të pikës 47) të këtij vendimi.

48. Pas marrjes së kërkesës nga pika 47) ose 48) e këtij vendimi, ofruesi i shërbimit pagesor të pranuesit korrigjon gabimin sipas detyrës zyrtare brenda 5 ditëve pune nga marrja e kërkesës dhe vepron si më poshtë:

- nëse miratohet llogari pagesore me shenjë identifikimi ndryshme nga i duhuri çfarë është e listuara në kopjen e urdhërpagesës të dorëzuar nga ofruesi i shërbimeve pagesore që kanë bërë gabim, lëshojnë një urdhërpagesë, me njoftim të njëkohshëm

- të pranuesit, me të cilin llogaria e pagesa e pranuesit që mbahet pranë tij, dhe miratohet llogaria pagesore së paguesit që është caktuar si urdhër dhënës të kopjes së urdhërpagesës së paraqitur me kërkesë ose miratohet llogaria pagesore e ofruesit të shërbimeve pagesore që kanë bërë gabim, sipas udhëzimeve të dhëna në kërkesë;
- nëse llogaria pagesore miratohet për një shumë më të madhe se shuma e deklaruar në kopjen e urdhërpagesës të dorëzuar nga ofruesi i shërbimit pagesor që ka bërë gabim, lëshon një urdhërpagesë, me njoftim të njëkohshëm të pranuesit, llogaria pagesore të përfituesit e mbajtur prej tij e cila debitohet për diferencën midis shumës së specifikuar në kopjen e urdhërpagesës dhe shumës së specifikuar në raportin e llogarisë pagesore të pranuesit, ose e gjithë shuma nëse është në kërkesë nga ofruesi i shërbimit pagesore cila bërë gabimi thuhet se është kryer përsëri urdhërpagesa e shumës së saktë dhe llogaria pagesore e paguesit të caktuar si dhënës i kopjes së urdhërpagesës së paraqitur me kërkesën miratohet, ose miratohet llogaria pagesore e ofruesit të shërbimit pagesor që ka bërë gabimin, sipas udhëzimeve të dhëna në kërkesë.

49. Ofruesi i shërbimit pagesor të pranuesit mund të debitoj llogaria pagesore të pranuesit, nëse e njëjtë ka mjete parash, deri në shumën e parave të gatshme aktivet që i nënshtrohen korrigjimit në gabim në pajtim me pikën 46) nga ky vendim, por jo më vonë nga afatin nga pika 47) nga ky vendim. Nëse në ditën e fundit të punës të afatit nga pika 47) nga ky vendim, nuk ka fonde të mjaftueshme në llogarinë e pranuesit për korrigjim të gabimit në shumë të plotë, ofruesi i shërbimit pagesor të pranuesit kryen korrigjimin e gabimit në një shumë të barabartë me bilancin e parave në llogarinë pagesore në atë moment.

50. Nëse llogaria pagesore së pranuesit nuk ka para të mjaftueshme për debitimin e plot në pajtim me pikën 46) nga ky vendim, ose llogaria pagesore është mbyllur, ofruesi i shërbimit pagesor të pranuesit njofton ofruesin e shërbimit pagesor që ka bërë gabimin.

51. Gjatë kryerjes së korrigjimit të një gabimi sipas detyrës zyrtare, ofruesit e shërbimeve pagesore të paguesit dhe të pranuesit janë të detyruar të informojnë menjëherë paguesin ose pranuesin, por jo më vonë se një ditë pune nga dita e kryerjes së korrigjimit të gabimit.

52. Korrigjimi sipas detyrës zyrtare i një gabimi mund të kryhet pavarësisht nga legjislacioni në fuqi ose aktet nënligjore ose kufizimet e marrëveshjet e lidhura kornizë nëse mjetet e marra si rezultat i zbatimit të gabuar të transaksionit pagesor nuk i përkasin pranuesit.

53. Për zbatim në korrigjimin në gabim sipas detyrës zyrtare asnjë tarifë nuk llogaritet dhe/ose mbliidhet nga përdoruesit e shërbimeve pagesore.

VIII. TRANSAKSIONE PAGESORE ME TRANSFERIME KREDITORE DHE DEBITIME TË DREJTPËRDREJTA NË EURO ME SKEMA PAGESORE SEPA

54. Ofruesit e shërbimeve pagesore i ekzekutojnë transaksionet e pagesave me transferime kreditore dhe debitime të drejtpërdrejta në euro në pajtim me këto kërkesa:

- duhet të përdorin IBAN-in si shenjë të vetme identifikimi të llogarisë pagesore, e ndërtuar në pajtim me rregulloret në Republikën e Maqedonisë së Veriut me të cilën rregullohen standardet e ndërtimit të llogarive pagesore pavarësisht të vendndodhjes së ofruesëve të shërbimeve pagesore në fjalë,

- duhet të zbatojnë format të porosive në pajtim me "ISO-standard 20022 XML", kur i transmetojnë transaksionet pagesore drejt një ofruesi tjetër të shërbimeve pagesor ose nëpërmjet sistemit pagesor të vogla,
- duhet të sigurohen se përdoruesit e shërbimeve pagesore përdorin shenja të vetme identifikuese në pajtim me nënpikën (1) të kësaj pike, pavarësisht nëse ofruesi i shërbimeve pagesore të paguesit dhe ofruesit të shërbimeve pagesore të pranuesit ose kur ofruesi i shërbimeve pagesore të paguesit që është ofruesit i shërbimeve pagesore dhe të pranuesit janë të bazuar dhe veprojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose një vendi tjetër anëtarë në SEPA, dhe
- duhet të sigurohen se kur përdoruesi i shërbimeve pagesore, i cili nuk është konsumator ose mikro tregtar, inicon ose pranon transferime individuale kreditore ose debitime direkte individuale, të cilat nuk transmetohen individualisht por së bashku në pako, zbatohet formati i porosisë të theksuar në nënpikën (2) të kësaj pike.

Pa qenë në kundërshtim me nënpikën (2) të paragrafit (1) të kësaj pike, ofruesi i shërbimeve pagesore me kërkesë konkrete të ofruesit të shërbimeve pagesore mund të përdorë format të porosive nga "ISO-standard 20022 XML" dhe në raport me atë përdorues të shërbimeve pagesore.

Përkrah kërkesave nga paragrafi (1) dhe (2) të kësaj pike, pranuesi që pranon transferime kreditore duhet t'ja tregojë paguesit shenjën identifikuese të llogarisë së tij pagesore siç është përcaktuar me paragrafin (1), nënparagrafin (1) të kësaj pike, çdo herë kur kërkohet realizim i transferimit kreditor.

Ofruesit e shërbimeve pagesore nuk duhet të kërkojnë nga përdoruesit e shërbimeve pagesore të fusin BIK të ofruesit të shërbimeve pagesore të paguesit ose BIK të ofruesit të shërbimeve pagesore të pranuesit.

55. Përveç kërkesave nga pika 55) e këtij vendimi, ofruesit e shërbimeve pagesore gjatë kryerjes së transaksioneve me transferim kreditor dhe debitim të drejtpërdrejt zbatohen këto kërkesa teknike:

- Fusha me të dhëna për shpjegime shtesë për pagesë duhet të lejojë 140 shenja. Skemat pagesore mund të lejojnë edhe numër më të madh të shenjave, vetëm nëse pajisja që përdoret për dërgimin e informacioneve ka kufizime teknike lidhur me numrin e shenjave në të cilin rast aplikohet kufiri maksimal i pajisjes;
- Shpjegimet shtesë për pagesë dhe elemente tjera që nuk janë të dorëzuara në pajtim me pikat 57) dhe 58) të këtij vendimi duhet të transmetohen në tërësi dhe pa ndryshime ndërmjet të gjithë ofruesëve të shërbimeve pagesore që nuk janë të përfshirë në realizimin e transaksionit pagesor.
- Pasiqë të dhënat e nevojshme do të jenë të disponueshme në formë elektronike, transaksionet pagesore duhet të mundësojnë përpunim elektronik plotësisht të automatizuar në të gjitha fazat e procesit nëpërmjet zinxhirit të pagesës (përpunim të drejtpërdrejtë, ang. end-to-end straight-through processing), që të mundet i tërë procesi i pagesës të zbatohet në mënyrë elektronike, pa nevojë për rihyrjen e të dhënave ose ndërmjetësim manual. Nëse është e mundur, e njëjta detyrimsht, i referohet edhe përpunimit individual të transaksioneve të transferimit kreditor dhe debitimit të drejtpërdrejt.
- Në skemat pagesore nuk duhet të përcaktohet pragu më i ulët i shumës së transaksionit pagesor për transferim kreditor ose debitim të drejtpërdrejt, por edhe nuk ekziston detyrim për përpunimin e transaksioneve pagesore vlera e së cilës është zero.

- Në skemat pagesore nuk ka detyrim për realizimin e transferimeve kreditore dhe debitimeve të drejtpërdrejta vlera e së cilave kalon 999.999.999,99.

Kërkesa dhe kushte shtesë për transferime kreditore

56. Ofruesit e shërbimeve pagesore, duke i respektuar dispozitat e Ligjit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, i realizojnë transferimet kreditore sipas këtyre kushteve:

57.1 Ofruesi i shërbimit pagesor të paguesit duhet të sigurojë se paguesi i ka dorëzuar këto elemente:

- emrin e paguesit dhe/ose numrin e llogarisë pagesore (IBAN);
- shumën e transferimit kreditor;
- numrin e llogarisë pagesore (IBAN) të pranuesit;
- emrin e paguesit, nëse është në dispozicion;
- shpjegime shtesë për pagesën.

57.2 Ofruesi i shërbimeve pagesore të paguesit është i detyruar që ofruesit të shërbimeve pagesore të pranuesit t'ia dorëzojë këto elemente:

- emrin e paguesit;
- numrin e llogarisë pagesore (IBAN) të paguesit;
- shumën e transferimit kreditor;
- numrin e llogarisë pagesore (IBAN) të pranuesit;
- shpjegime shtesë për pagesën;
- çfarëdo shenje identifikimi unike për pranuesin;
- emrin e palës referuese të pranuesit;
- përshkrimin e transferimit kreditor;
- shifra e përshkrimit të transferimit kreditor.

57.3 Përveç elementeve nga nënpika (57.2), ofruesi i shërbimeve pagesore të paguesit është i detyruar që ofruesit të shërbimeve pagesore t'ia dorëzojë edhe këto elemente:

- BIK-un e ofruesit të shërbimeve pagesore të paguesit (nëse ofruesit e shërbimeve pagesore që marrin pjesë në transaksionin pagesor nuk bien dakord ndryshe);
- BIK-un e ofruesit të shërbimeve pagesore të pranuesit (nëse ofruesit e shërbimeve pagesore që marrin pjesë në transaksionin pagesor nuk bien dakord ndryshe);
- shenjën e vetme identifikuese të skemës pagesore;
- datën e realizimit të transferimit kreditor;
- numrin referues të porosisë për transferim kreditor të ofruesit të shërbimeve pagesore të paguesit.

57.4 Ofruesi i shërbimeve pagesore të pranuesit është i detyruar që pranuesit t'ia dorëzojë këto elemente:

- emrin e paguesit;
- shumën e transferimit kreditor;
- çdo informacioni për sqarim të pagesës.

Kërkesa dhe kushte shtesë për debitimet e drejtpërdrejta

57. Ofruesit e shërbimeve pagesore, duke i respektuar dispozitat e Ligjit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, i realizojnë debitimet direkte sipas këtyre kushteve:

58.1 Ofruesi i shërbimeve pagesore të pranuesit duhet të sigurohet se pranuesi gjatë debitimit të parë të drejtpërdrejtë, debitimit e drejtpërdrejtë të njëhershëm dhe me çdo transaksion pagesor të ardhshëm, i ka dorëzuar këto elemente:

- llojin e debitimit të drejtpërdrejt (i përsëritur, një herë, i pari, i fundit ose revokues),
- emrin e pranuesit,
- numrin e llogarisë pagesore (IBAN) të pranuesit e cila do të miratohet për arkëtim,
- emrin e paguesit, nëse e dhëna është në dispozicion,
- numrin e llogarisë pagesore (IBAN) të paguesit e cila do të debitohet shkaku arkëtimit,
- shenja e vetme referuese e pëlqimit,
- data e paraqitjes së pëlqimit,
- shuma për arkëtim,
- shenja e vetme referuese e pëlqimit, të cilën e ka dorëzuar pranuesi fillestar të pagesës që e ka lëshuar pëlqimin (nëse pëlqimi është marrë nga pranuesi i pagesës që nuk është pranuesi i pagesës që e ka lëshuar pëlqimin),
- shenja e vetme identifikuese e pranuesit,
- shenja e vetme identifikuese e pranuesit fillestar që e ka lëshuar pëlqimin (nëse pëlqimi është marrë nga pranuesi i cili nuk është pranuesi që e ka lëshuar pëlqimin),
- sqarime shtesë për pagesën të cilat pranuesi i dorëzon te paguesi,
- baza e debitimit të drejtpërdrejt,
- shifra e bazës së debitimit të drejtpërdrejt.

Ofruesi i shërbimeve pagesore të pranuesit është i detyruar të sigurojë se paguesi ka dhënë pëlqim për debitim të drejtpërdrejtë të pranuesit si dhe të ofruesit të shërbimeve pagesore të paguesit, direkt ose indirekt nëpërmjet pranuesit. Pëlqimet për debitim të drejtpërdrejt, së bashku me ndryshimet ose anulimet e mëvonshme, mbahen nga ana e pranuesit ose nga pala e tretë në emër të pranuesit ku ofruesi i shërbimeve pagesore të pranuesit e informon pranuesin për detyrimin e caktuar në pajtim me nenet 56 dhe 58 të Ligjit.

58.2 Ofruesi i shërbimeve pagesore të paguesit është i detyruar që ofruesit të shërbimeve pagesore të paguesit t'i dorëzojë këto elemente:

- BIK-un e ofruesit të shërbimeve pagesore të pranuesit (nëse ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët kanë marrë pjesë në transaksionin pagesor nuk dakordohen ndryshe)
- BIK-un e ofruesit të shërbimeve pagesore të paguesit (nëse ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët marrin pjesë në transaksionin pagesor nuk dakordohen ndryshe),
- emrin e palës kontraktuale referuese të paguesit (nëse ekziston në pëlqim të dematerializuar),
- shenjen e vetme identifikuese të palës kontraktuale referuese të paguesit (nëse ekziston në pëlqim të dematerializuar),
- shenjën e vetme identifikuese të skemës pagesore,
- datën e shlyerjes së arkëtimit,
- shenjën referuese e ofruesit të shërbimeve pagesore të pranuesit,
- llojin e pëlqimit,
- llojin e debitimit direkt (i përsëritur, një herë, i pari, i fundit ose revokues),
- emrin e pranuesit të pagesës,
- numrin e llogarisë pagesore (IBAN) të pranuesit e cila do të miratohet shkaku i arkëtimit,

- emrin e paguesit,
- numrin e llogarisë pagesore (IBAN) të paguesit e cila do të miratohet shkakt i arkëtimit,
- shenja e vetme identifikuese e pëlqimit,
- data e paraqitjes së pëlqimit,
- shuma për arkëtim,
- shenja e vetme referuese e pëlqimit, të cilën e ka paraqitur pranuesi fillestar të pagesës i cili e ka lëshuar pëlqimin (nëse pëlqimin e ka marrë pranues i pagesës i cili nuk është pranues i pagesës që e ka lëshuar pëlqimin),
- shenja e vetme identifikuese e pranuesit fillestar i cili e ka lëshuar pëlqimin (nëse pëlqimi është marrë nga pranues i cili nuk është pranuesi që e ka lëshuar pëlqimin),
- sqarime shtesë për pagesën të cilën pranuesi ia paraqet paguesit.

58.3 Ofruesi i shërbimeve pagesore të paguesit është i detyruar që paguesit t'i dorëzojë të dhënat në vijim:

- shenjën e vetme referuese të pëlqimit,
- shenjen e vetme identifikuese të pranuesit,
- emrin e pranuesit,
- shuma e arkëtimit,
- sqarime shtesë për pagesën,
- kodi identifikues i skemës pagesore.

58.4 Paguesi ka të drejtë të jep instruksione te ofruesit i tij i shërbimeve pagesore:

- ta kufizojë arkëtimin e debitimit të drejtpërdrejtë të një shume ose afatizimi të caktuar ose ti bëjë të dy veprimet;
- kur pëlqimi sipas skemës së debitimeve direkte nuk parasheh të drejtën e kthimit të fondeve, ta vërtetojë çdo transaksion me debitim direkt dhe të kontrollojë nëse shuma dhe afatizimi i transaksionit të nisur me debitim direkt është e barabartë me shumën dhe afatizimin e dakorduar në pajtim me debitimin direkt, para se të debitojë llogarinë pagesore të paguesit, në bazë të informacioneve të paraqitura në pajtim me debitimin direkt;
- të bllokojë të gjitha debitimet direkte të llogarisë pagesore të paguesit ose të bllokojë të gjitha debitimet direkte të inicuar nga një ose më shumë pranues të specifikuar ose të miratojë të gjitha debitimet direkte të inicuar nga një ose më shumë pranues të specifikuar;

58.5 Kur paguesi dhe pranuesi nuk janë konsumatorë, ofruesit e shërbimeve pagesore nuk kanë detyrim që ti plotësojnë kërkesat e caktuara në nënpikën (58.4) nga ky vendim.

58.6 Ofruesi i shërbimeve pagesore të paguesit është i obliguar të informojë paguesin për të drejtat e theksuara në nënpikën (58.4) në pajtim me nenet 56 dhe 58 të Ligjit.

58.7 Gjatë transaksionit të parë pagesor me debitim direkt ose transaksion pagesor njëherë me debitim direkt dhe gjatë çdo transaksioni vijues me debitim direkt, pranuesi

duhet ti dërgojë informacionet e lidhura me pajtueshmërinë për debitim direkt deri te ofruesi tij të shërbimeve pagesore i cili më tej duhet ti përcjell deri te ofruesi i shërbimeve pagesore të paguesit për çdo transaksion pagesor individual me debitim direkt.

58.8 Para transaksionit të parë pagesor me debitim direkt, paguesi është i detyruar të informojë pranuesin për shenjën identifikuese të llogarisë së tij pagesore të specifikuar në pikën 55), paragrafin (1), nënparagrafi (1) i këtij vendimi.

58.9 Kur marrëveshja kornizë është lidhur mes paguesit dhe ofruesit të shërbimeve pagesore të paguesit nuk definon të drejtën e kthimit të fondeve, ofruesi i shërbimeve pagesore të paguesit është i detyruar pa përjashtimin e dispozitës nga nënpika (58.1), paragrafi (2) të këtij vendimi, ta vërtetojë çdo transaksion pagesor me debitim direkt që ta kontrollojë nëse shuma e transaksionit të nisur për debitim direkt është e barabartë me shumën dhe afatizimin të dakorduar në pëlqimin për debitimin direkt para se të debitohet llogaria pagesore e paguesit në bazë të informacioneve të specifikuara në pëlqimin për debitim direkt.

58.10 Ofruesi i shërbimeve pagesore të paguesit dhe ofruesit të shërbimeve pagesore të pranuesit nuk kanë të drejtë të arkëtojnë kosto dhe tarifa shtesë në procesin e ngarkimit të pëlqimit të gjeneruar automatikisht për transaksionet pagesore të inicuarra nëpërmjet ose me një kartelë pagesore në një pajisje terminale në pikë të shitjes, që rezultojnë me debitim direkt.

IX. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

58. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar të harmonizohen me dispozitat e pikave 25), 29), 30), 32), 34), paragrafi (2), (39) dhe (40) të këtij vendimi, jo më vonë se 1 nëntori 2025.

Dispozitat nga pika 3) dhe kreu VIII të këtij vendimi do të fillojnë të zbatohen në ditën e integritetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në SEPA.

Dispozitat nga pikat 26) dhe 27) nga ky vendim do të fillojnë të zbatohen në ditën e fillimit të zbatimit të dispozitave nga pjesa shtatë, kreu III të ligjit.

59. Në ditën e fillimit të zbatimit të pjesës së shtatë, kreu II të ligjit pushon të vlejë pika 12), paragrafi (2), nënparagrafi (1) të këtij vendimi.

60. Guvernatorja e Bankës Popullore me udhëzim përshkruan formën në letër të urdhërpagesave, pëlqimin për debitimin të drejtëpërdrejt dhe autorizimin për bartjen e llogarisë pagesore, listën e kodeve për përshkrimin e pagesave, si dhe përmbajtjen e fletëpalosjes informative për llogarinë pagesore me funksione bazë.

61. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi pushon të vlejë Vendimi për kryerjen e transaksioneve pagesore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 289/22, 80/23 dhe 275/23).

62. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë të publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

V. nr. 02-24947/3

2024 Shkup

**Guvernatorja dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë së Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска**